

ADVANTAGE

THE OFFICIAL MAGAZINE OF THE AMERICAN CHAMBER OF COMMERCE IN ALBANIA

Doganat dhe tatimet përballë biznesit të AmCham

Krijohet Komiteti i CSR-së në AmCham

Ambasadori Lu viziton zyrat e AmCham

Customs and tax officials face AmCham businesses



MIELL TIRANA SH.A.

Fabrika me moderne per prodhimin e miellit ne Shqiperi. Ajo punon me teknologjine me te perparuar ne bote "BUHLER", me kapacitet perpunues 240 ton/dite MIELL TIRANA SH.A. mbulon 30% te nevojave te tregut te brendshem per miell.

This company is the most modern factory of flour production in Albania. It operates through the most advanced technology in the world "BUHLER" with a manufacturing capacity of 240 ton/ per day. "Miell Tirana" Sh.A Company covers 30% of the demands of the domestic market for flour.



"MIELL TIRANA" SH.A. RR. AGIM QARRI, NR.1, TIRANE - ALBANIA

Tel/Fax: +355 4 2225619, 2271777, E-mail: info@mielltirana.com, www.mielltirana.com

Floriol. Shija e jetës!



floriol



**Ferra
Latte**

.....i shëndetshëm si fëmija juaj



CONTENT / PERMBAJTJA

AmCham News / Lajme

AmCham holds meeting with Tax Director Shehaj	8-15
Dhoma Amerikane takohet me Drejtorin e Tatimeve Shehaj	16-20
Customs Director Spiropali discusses procedures and legal changes with AmCham businesses	21
Drejtorja e Doganave Spiropali flet me biznesin e AmCham për procedurat dhe ndryshimet ligjore	22-23
AmCham helps address Shkodra business community concerns	24-27
Dhoma Amerikane ndihmon në trajtimin e çështjeve të biznesit shkodran	28-29
AmCham Board meets with U.S. Department of State's top official for Southeast Europe	30
Bordi i Dhomës Amerikane takohet me Drejtorin e Departamentit të Shtetit për Europën Juglindore	32-33
AmCham organizes third IPR conference	34-45
AmCham organizon raundin e tretë të Konferencës së IPR-it	36-37
WoBAC discussed women's achievements in entrepreneurship with Deloitte	38-41
WoBAC flet me Deloitte & Touche mbi arritjet e grave në sipërmarrje	42-43
WoBAC visits Cubi Art Gallery studio	52-55
WoBAC viziton studion e Art Galerit Cubi	56-57
Ambassador Donald Lu visits AmCham offices	58
Ambasadori Donald Lu viziton Dhomën Amerikane të Tregtisë	44-47
Ambassador Donald Lu chooses Elbasan for first visit	
Ambasadori Donald Lu takimin e parë në Elbasan	
Members' expectations on the government's VAT law implementation	
Çfarë presim nga qeveria për zbatimin e ligjit të TVSH-së	
Social Responsibility brings AmCham members together	
Përgjegjësia Sociale bashkon anëtarët e Dhomës Amerikane të Tregtisë	
AmCham members commit to help residents in flooded areas	
Anëtarët e Dhomës Amerikane angazhohen për të ndihmuar banorët në zonat e përmbytura	
AmCham members Celebrate Holiday Season	
Anëtarët e AmCham bashkohen për Festat e Fundvitit	
Floreta Luli-Faber / When an organization and its leader grow together	
Floreta Luli Faber / Kur organizata dhe lideri rriten së bashku	
Dhoma Amerikane merr Çertifikatën e Meritës në Ditën Ndërkombëtare të Doganave	
AmCham receives Certificate of Merit on International Customs Day	
FREE ZONES	48-51
ZONAT E LIRA	

Member News / Lajme Anëtarësh

Economy / Ekonomi

FREE ZONES

ZONAT E LIRA

AMCHAM BOARD



President

Mark C. CRAWFORD
*Aksioner International
Securities Brokerage*



Vice-President

Genti DACI
ABCom



Secretary

Genci LIKOSKENDAJ
*CCS Computer & Copier
Systems*



Treasurer

Alketa URUÇI
Boga & Associates

Board Members



Adrian SHEHU
T.C.N



Aleksandër SARAPULI
*Albanian-American
Enterprise Fund*



Avni PONARI
*SIGAL Uniqa Group
Austria*



Elton ÇOLLAKU
*Financial Union
Tirana-Western Union*



Julia JANECKO
*Abraham Lincoln
Foundation*



Loreta PEÇI
*PricewaterhouseCoopers
Audit*



Peter CLAVELLE
Tetra Tech ARD



Floreta LULI-FABER
*Executive Director
AmCham Albania*



Me energji të pastër



50 pika karburanti
në Shqipëri



15 pika karburanti
në Kosovë




Ekport në Maqedoni
dhe Mal të Zi



"Europetrol Durrës Albania" sh.a

SUSTAINING MEMBERS



ANETARE PRESIDENCIALE

 KALO ASSOCIATES ATTORNEYS AT LAW	 TIRANA BANK	 ALBANIAN-AMERICAN ENTERPRISE FUND	 KORÇA 1928	 BOGA & ASSOCIATES LEGAL - TAX - ACCOUNTING
 ZI.CO*SH.A. Food Import - Export, Tirana, Albania	 vodafone	 SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA	 ADI sh.a.	 ALD KRIS
 Banka Ndërkombetare Tregtare International Commercial Bank	 FUFARMA S.R.L. 1946 Tirana - Albania	 AK-INVEST Institution Financial	 HOTEL COLOSSEO SHKODËR	 Tirana International Airport Nënë Tereza
 ALUMIL Building excellence every day	 AVON the company of women	 EGNATIA GROUP	 STEFANI & CO	 UBA United Bank of Albania Banka e Bashkuar e Shqipërisë
 Seament Albania	 Korsel	 Microsoft	 ALUFLO	 ICTS Albania
 JTi Japan Tobacco International	 ProCredit Bank Albania	 Friends Distribucion	 Albania Duty Free	 Grant Thornton An instinct for growth™
 BOZO ASSOCIATES attorneys at law	 B & B Food Service	 ALPHA BANK	 gsk GlaxoSmithKline	 Dimapak sh.p.k.
 hp	 Teuta	 TIRANA BUSINESS PARK	 KASTRATI GROUP	 Devoll Hydropower
 COF CASA	 RENOVA PUTZ	 Bereget CATERING	 TURGUT ÖZAL EDUCATION COMPANY	 Tendence 3A

AmCham holds meeting with Tax Director Shehaj



TAX OFFICIALS, *businesses face challenges related to legislative changes*

The American Chamber of Commerce in Albania organized a Business Forum with the Director General of Taxation, Brisida Shehaj, focusing on fiscal enforcement as well as the new fiscal package and its adoption. The meeting was characterized by an open discussion of procedural issues arising in particular from the application of new guidelines.

Director Shehaj said drafting policies, tax laws and guidelines are the jurisdiction of the Ministry of Finance, while the institution she leads focuses solely on their implementation. AmCham members brought several problems relating to implementation of policies, such as to the treatment of bad debts, the issue of payment of dividend on the due date, problems moving data from one system to another and several other issues. In their presentation,

representatives of the Directorate General of Taxation explained to AmCham members the changes the Fiscal Package brings in 2015 and the new elements and benefits it introduces into the tax system.

These include electronic filing for tax liabilities for all types of taxes and fees collected by the tax administration as well as using modern accounting methods for contemporary financial situations, constituting mutual benefits for business and the tax administration. Thus the new system is expected to significantly improve tax administration communications with the taxpayers, using only electronic communications in the future. AmCham members, through their representatives at the Tax and Legal Committee, raised issues that concern the general business community as well as some individual problems.

Tax and Legal Committee discusses AmCham member issues

A new ordinance on "The Value Added Tax in the Republic of Albania" was approved and entered into force on Jan. 30, 2015 with legal effects starting Jan. 1, 2015, when the new VAT law entered into force. Considering that the new reporting system with tax authorities became

Dhoma Amerikane takohet me Drejtoreshen e Tatimeve Shehaj

TATIMORËT DHE BIZNESI

përballë sfidave të ndryshimeve ligjore



Dhoma Amerikane e Tregtisë organizoi takimin Forum Biznesi me Drejtoreshen e Përgjithshme të Tatimeve, znj. Brisida Shehaj, të fokusuar në çështjet që lidhen me zbatimin e ligjit nga administrata tatimore, paketa e re fiskale dhe adoptimi i saj në sistemin tatimor. Takimi u karakterizua nga diskutime të hapura për çështje proceduriale, që vijnë sidomos nga zbatimi i udhëzimeve.

Në prezantimin e tyre, përfaqësuesit e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve i njohën anëtarët e Dhomës me ndryshimet që kishte pësuar Paketa Fiskale 2015, ristë që sjell ajo si dhe ndryshimet dhe benefitet e sistemit të ri tatimor.

Deklarimi elektronik i detyrimeve tatimore për të gjitha llojet e tatimeve dhe taksave që mbledhen nga Administrata Tatimore si dhe kontabilizimi i detyrimeve dhe pagesave si një sistem modern dhe bashkëkohor për situatat financiare, përbënin përfitime të dyanshme për biznesin dhe administratën tatimore që vijnë nga ndryshimet në sistemin tatimor. Kështu, me sistemin e ri pritët që të përmirësohen ndjeshëm komunikimet e administratës tatimore me tatimpaguesin, duke e përmirësuar atë nëpërmjet dhe vetëm me komunikim elektronik. Anëtarët e Dhomës Amerikane nëpërmjet përfaqësuesve të tyre në Komitetin e Taksave dhe Ligjeve, kanë ngritur problematika që shqetësojnë në përgjithësi komunitetin e biznesit, por dhe problematika individuale. Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve ka qenë e mendimit që pjesën e politikës mbi hartimin e ligjeve dhe udhëzimeve e mban Ministria e Financës ndërkohë që, Drejtoria e Tatimeve përqendrohet tek zbatimi i ligjit. Pikërisht tek zbatimi i ligjit, anëtarët e Dhomës Amerikane kanë sjellë disa probleme që kanë të bëjnë me trajtimin e borxheve të këqija, çështjen e pagimit të dividendit në ditën e pagesës, probleme të kalimit të të dhënave nga një sistem në tjetrin, etj.

Komiteti i Taksave dhe Ligjeve flet për problematikat e anëtarëve të AmCham

Ne 30 Janar 2015 është miratuar dhe ka hyre në fuqi Udhëzimi i Ri "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë" i cili i ka shtrirë efektet e veta juridike duke filluar nga data 1 Janar 2015, date në të cilën hyri në fuqi edhe ligji i ri për TVSH. Për këtë qëllim si edhe duke marrë në konsideratë se nga data 1 Janar filloi të funksionojë edhe sistemi i ri i raportimit pranë organeve tatimore si edhe duke marrë në konsideratë shqetësime të tjera të anëtarëve të Dhomës Amerikane në lidhje me paketën fiskale në përgjithësi, u zhvillua në datën 5 Shkurt një forum me pjesëmarrjen e anëtarëve të Dhomës Amerikane dhe Drejtoreshes së Përgjithshme të Tatimeve si dhe përfaqësues të tjerë të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Në këtë takim u ngritën disa shqetësime të cilat vinin si rrjedhojë e miratimit të Ligjit të Ri të TVSH dhe Udhëzimit përkatës. Është shqetësuese fakti që aktet nenligjore që duhet të dalin në bazë dhe për zbatim të ligjeve, përgatiten me vonesë dhe lihet fare pak kohë për konsultime me grupet e interesit dhe për më tepër miratohen me vonesë dhe në të njëjtën kohë u jepet fuqi prapavepruese. Edhe në rastin konkret ky Udhëzim duke u miratuar me vonesë nuk lejon kohën e nevojshme që të dyja pelet të njihen me ate dhe ta zbatojnë atë në praktikë. Si nga ana e biznesit që duhet të zbatojë por edhe nga ana e organeve tatimore Inspektorët e se ciles duhet ta zbatojnë atë në praktikë. Duke ju referuar kërkesave të shprehura prej anëtarëve të Dhomës janë theksuar në veçanti disa shqetësime të industrisë së telekomunikacionit, industrisë së duhanit si dhe disa çështje me rëndësi në lidhje me rimbursimin e TVSH-së dhe taksave për Akcizën dhe Karbonin.

Në lidhje me sa më lart, Dhoma Amerikane e Tregtisë ka parashtruar disa sugjerime konkrete.

Sa i takon industrisë së telekomunikacionit mbi të cilën ka një ndikim të konsiderueshëm parashikimi sipas të cilit çdo mall i vënë në dispozicion i nevojshëm për ofrimin e shërbimit prej furnizuesit janë pjesë e furnizimit të shërbimit. Çdo vlerë e paguar nga klienti ose çdo vlerë e mbajtur në formë garancie nga furnizuesi i shërbimit në funksion të realizimit të kontratës së shërbimit për vetë

operational starting Jan. 1, and taking into account other concerns by members of the American Chamber of Commerce in Albania regarding the Fiscal Package in general, a forum was held on Feb. 5 with AmCham representatives, the Customs Director General and representatives of the tax administration.

Members raised several concerns related to the approval of the new law on VAT and the associated instructions and ordinances. AmCham is concerned by the fact that the by-laws intended for the implementation of laws are compiled with delays and a very short time is left available for consultation with interest groups. In addition to delays in their approval, the by-laws are also given retroactive effects. Even in this particular case, the late approval of this ordinance does not allow the involved parties to get acquainted with it and put it into practice.

Referring to requests made by chamber members, concerns were specifically related to the telecommunication and tobacco industries as well as several important issues regarding VAT refunds and the excise and carbon taxes. AmCham has made some concrete suggestions regarding these issues. In the telecommunication sector where the stipulation that every product made available for use and that needs a service provider is part of the service provision has a considerable impact. Every amount paid by the customer or every amount kept as a guarantee by the service provider as part of fulfilling the service contract for the service itself or every product involved in the service supply comprises the value of the taxable service. For this reason, a change has been suggested to this by-law because the guarantee kept as part of the right to use a product for service provision purposes cannot be an element or part of the service provision. Regarding the tobacco industry, the VAT ordinance has envisaged that the main supplier guarantees that cigarettes' market price in the chain until their sale to the end consumer is the same to the price declared and determined by them. The ordinance also holds responsible "the main supplier" (the importer) "to force," among others, intermediate suppliers and retail traders all over the country that in case of price changes they must report to the main supplier on the stock of the product left and the latter must calculate, declare and pay VAT for the price difference of the stock on the date of the price change. Such a demand places control functions on the importer that are not envisaged by law, and, in practice, leaves room for abuse and misuse (i.e. only small quantities or nothing at all will be reported). Once a deadline has been set for the reimbursement of VAT, in order for this deadline to be met, AmCham suggests that a determination be made on the stage where the legal obligation for payment by the Treasury starts -- determining when the five-day period begins. It should also specify that if the refund is not issued, regardless whether a check has been made or not, the taxable person should be entitled to non-payment of other tax liabilities in the amount of VAT claimed for reimbursement.

Regarding the considerable financial burden that stems from excise duties, although the Law "On Excise Taxes in Albania" provides reimbursement of excise for a limited period of five years, businesses have faced many difficulties, which have led to lack of reimbursement for the 2012-2014 period, a time-frame which was included in the Government Decision that allows the tax authorities to continue issuing VAT refunds accumulated from Jan. 1, 2014. Therefore, as suggested above, and taking into

account at the same time the important contribution of these taxes to the public budget, an alternative would be the replacement of such tax with a VAT equivalent or other taxes applicable in the sale of the final product (cement) or removal of the equivalent excise and carbon taxes to the extent applicable to exports made by a local producer and the application of an equivalent import duty at customs for imported products. On all of these issues, there should be more communication with the interest groups as well as legal arrangements should be made to streamline tax procedures and ease financial burden on businesses, while at the same time guaranteeing that the state gets the required tax income.

BAD DEBT ISSUES

The tax administration refuses to recognize the bad debts owed to taxpayers, although the latter have taken all possible legal action to collect on the debt. These actions include the pursuit of a judicial process for the recognition of the obligation of the debtor until the court decision becomes final, starting the execution procedure from bailiffs. The claim by tax administration officials is that, until Dec. 31, 2014, the taxpayers had not initiated/finalized the procedure of bankruptcy for the debtor, thus stopping official recognition as a bad debt. The only condition stipulated by Law 7928/1995 "On VAT" is that an outstanding debt becomes a bad debt when six months have passed since the date of invoice. Meanwhile, the Minister of Finance's Instruction 17/2008 established that "the main evidence that the seller is obliged to submit is the decision of the court in which it is determined that the buyer is an insolvent debtor and, therefore, for these reasons not able to pay the seller the value of what was supplied. Without this decision, the tax authorities can not in any case accept it as a bad debt."

In addition, Law 8438/1998 "On income tax" provides a condition that the taxpayer needs "to have taken all possible legal action for the collection of the debt". The interpretation of the VAT Directive by tax inspectors is wrong. Declaring bankruptcy as a condition for recognition of bad debt must be understood only as one of the cases which the bad debt is recognized by authorities as such. This cannot be considered a "necessary condition" in all cases. Performing judicial proceedings (including execution of the decision through a bailiff) for collecting bad debts is an alternative to seeking the debtor's bankruptcy procedure and in both cases (a declaration by the bailiff that the debtor has no assets or a decision of bankruptcy in court for the debtor) should be sufficient for the recognition of bad debts for purposes of VAT. In contrast, after a company performs the judicial process and follows (though without success in the collection of the obligation) the proper procedures through the court and bailiffs, it is not effective to proceed with the procedure to declare bankruptcy as long as the client does not possess any income and wealth (which can be certified by the Bailiff Office) and as such would not be able to afford even the costs of the bankruptcy procedure. This problem seems likely to continue in the coming years. The new law on VAT requires the recognition of bad debt be made when a debt is declared as uncollectible by the judicial authorities. Meanwhile, the new VAT instruction contains the same provision as the previous instruction (i.e. bad debt is recognized when the supplier proves to a court that the buyer is a bankrupt debtor and as such the debt cannot be collected).





shërbimin ose për cdo mall të përfshirë në furnizimin e shërbimit përbëjnë vlerën e tatueshme të furnizimit.

Për këtë arsye është sugjeruar ndryshimi i këtij parashikimi, pasi garancia e mbajtur në funksion të të drejtës për të përdorur një mall për qëllime të ofrimit të shërbimit nuk mund të jetë element apo pjesë e furnizimit të shërbimit. Në lidhje me industrinë e duhanit, Udhëzimi i TVSH-së, ka parashikuar se Furnizuesi kryesor garanton që çmimi i cigareve në treg deri në shitjen e tyre tek konsumatori final është aq sa çmimi i deklaruar dhe përcaktuar prej tij.

Gjithashtu, ka ngarkuar me përgjegjësi “Furnizuesin kryesor” (importuesin) që “te detyroje” nder te tjera edhe furnizues të ndërmjetëm dhe shitës me pakice në të gjithë vendin, që ne raste ndryshimi çmimi t’i raportojnë “Furnizuesit kryesor” gjendjen e mallit dhe ky i fundit të llogarisë, deklarojë dhe paguajë TVSH-në për pjesën e rritur të çmimit për mallin gjendje në datën e ndryshimit të çmimit. Vërehet se një kërkesë e tillë i ngarkon atij funksione kontrolli që nuk ia lejon ligji dhe në praktikë, kjo thjesht do të abuzohet apo keqpërdoret (do raportohen sasi të vogla ose fare). Pasi është vendosur një afat për rimbursimin e TVSH-së dhe në mënyrë që ky afat të jetë efektiv, Dhoma Amerikane sugjeron që të përcaktohet në cilin moment fillon detyrimi ligjor për kryerjen e pagesës nga thesari pra, kur fillon afati 5 ditor. Gjithashtu duhet specifikuar se nëse nuk kryhet rimbursimi brenda afatit, pavarësisht se është bërë apo jo kontroll, personit të tatueshëm i lind e drejta e mospagesës së detyrimeve të tjera tatimore në masën e TVSH-së së pretenduar për rimbursim.

Lidhur me barrën financiare të konsiderueshme dhe sa i përket Akcizës, edhe pse Ligji “Për Akcizën në Shqipëri”, parashikon rimbursimin e akcizës për një periudhë të kufizuar prej 5 vjet, shoqërite kanë hasur shumë vështirësi, të cilat kanë ndikuar në moskompensimin për periudhën 2012-2014 periudhë për të cilën tashme ka një VKM që lejon organet tatimore të vazhdojnë rimbursimin nga e TVSH të akumuluar nga data 1 Janar 2014. Ndaj, sugjerohet për sa më sipër, si dhe duke marrë parasysh në të njëjtën kohë kontributin e rëndësishëm të këtyre taksave në buxhetin publik, një zgjidhje alternative do të ishte zëvendësimi i taksave të tilla me TVSH-në ekuivalente apo taksa të tjera të zbatueshme në shitjen e produktit final (çimento) apo heqjen e taksës ekuivalente të akcizës dhe të karbonit në masën e zbatueshme për eksportet e kryera nga prodhuesi vendas, si dhe aplikimin në import të

një takse doganore ekuivalente. Për te gjitha keto kerkohet nje bashkediskutim me i ngushte me grupet e interesit dhe nje rregullim ligjor qe do te lehtësonte procedurat tatimore dhe gjendjen financiare te biznesit por ne te njejtën kohë do te garantonte edhe pagesat e detyrimeve tatimore ndaj shtetit.

Problematikat e evidentuara gjatë takimit PROBLEMATIKA E BORXHIT TË KEQ

Administrata tatimore refuzon njohjen e borxheve të këqija nga tatimpaguesit, megjithëse këta të fundit kanë ndërmarrë të gjitha veprimet e mundshme ligjore për arkëtimin e borxhit. Këto veprime përfshijnë ndjekjen e procesit gjyqësor për njohjen e detyrimit të debitorit derisa vendimi i gjykatës merr formë të prerë si dhe ndjekjen e procedurës së ekzekutimit të detyrueshëm me organet përmbartimore. Pretendimi i administratës tatimore për periudhat deri me 31.12.2014 është se tatimpaguesit nuk kanë iniciuar/finalizuar procedurën e falimentimit për debitorin. I vetmi kusht që parashikonte ligji 7928/1995 “Për TVSH-në” kur një borxh i papaguar bëhet një borxh i keq, ishte kalimi i afatit 6-mujor nga data e lëshimit të faturës. Ndërkohë që, Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 17/2008 përcaktonte se “prova kryesore që detyrohet të paraqesë shitësi, është Vendimi i Gjykatës, në të cilin vërtetohet se blerësi i tij është debitor dhe ka falimentuar, prandaj për këto arsye nuk mund t’i paguajë shitësit vlerën e furnizimit të marrë. Pa këtë vendim, organet tatimore nuk mundën në asnjë rast të pranojnë borxhin e keq si të tillë”.

Edhe ligji 8438/1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” parashikon si kusht që tatimpaguesi “të ketë ndërmarrë të gjitha veprimet e mundshme ligjore për arkëtimin e tij”. Interpretimi i Udhëzimit të TVSH-së nga ana e inspektorëve tatimorë është i gabuar. Shpallja e falimentimit si kusht për njohjen e borxhit të keq, duhet kuptuar vetëm si njëri nga rastet kur bëhet njohja e borxhit të keq. Ky kusht nuk mund të konsiderohet si “kusht i domosdoshëm” në të gjitha rastet. Kryerja e procedurave gjyqësore (duke përfshirë ekzekutimin e vendimit përmes Zyrës së Përmbartimit) për mbledhjen e borxheve të këqija, është një alternativë e ndjekjes së procedurës së falimentimit të debitorit dhe të dyja rastet (deklarimi nga Zyra e Përmbartimit se debitori nuk ka pasuri apo vendimi i gjykatës për falimentim të debitorit) do të ishin të mjaftueshme për njohjen e borxheve të këqija për efekt të TVSH-së.

Në të kundërt, pasi kemi kryer procesin gjyqësor dhe kemi ndjekur (megjithëse pa patur sukses në arkëtimin e detyrimit) procedurën me organet përmbartimore, nuk do të ishte efikase të vazhdohej me procedurën për shpalljen e falimentimit për aq kohë sa klienti nuk zotëron asnjë të ardhur dhe pasuri (e cila është vërtetuar nga Zyra e Përmbartimit) dhe si i tillë nuk do të ishte në gjendje të përballonte as kostot e procedurës së falimentimit. Kjo problematikë duket se do të vazhdojë edhe në vitet në vijim. Ligji i ri për TVSH-në kërkon që njohja e borxhit të keq të bëhet kur pagesa është shpallur si e pambledhshme nga organet gjyqësore. Ndërkohë që, Udhëzimi i ri i TVSH-së përmban të njëjtën dispozitë si udhëzimi i mëparshëm (pra, borxhi i keq njihet si i tillë nëse furnizuesi nuk vërteton me vendim gjykatë se blerësi i tij është debitor dhe ka falimentuar, e për pasojë, borxhi nuk mund të arkëtohet).

The new information system does not allow for declaration and payment of tax by foreign individuals on income generated in Albania

Under the implementation of a new information system by the tax administration, any payment to the administration is carried out only with the respective payment order printed from the online system. Under the guidance of the Minister of Finance, foreign individuals who have to pay tax in Albania must visit the Regional Tax Offices in order to register in the information system for payment of tax liabilities.

Currently, the Regional Tax Offices do not perform this registration and therefore the process of payment of tax liabilities becomes impossible. Besides revenue shortfalls in the state budget as a result of this problem, it also causes concern for individuals who have been delayed in paying their obligations and might be later penalized for it. There is also concern over the method of payment of these taxes. The tax legislation mandates payment of tax liabilities which are not subject to withholding of tax at source on 20th day of the month following payment, while the system is set up to only accept annual disclosures.

An example of a guidance issued by the Ministry of Finance in conflict with the spirit of the law

A good example can be seen in interpretation of Article 75/1 of Law 9920 "On Tax Procedures." It mandates that "If taxable persons are registered for VAT purposes, have outstanding credit and present to the tax regional offices a request for reimbursement of VAT paid, the tax administration, within 60 calendar days (30 days for exporters), verifies the accuracy of the claim, notifies the taxpayer and effectuates reimbursement when the conditions are met. Otherwise, the taxable person is entitled to non-payment of other tax liabilities in the amount of VAT claimed for reimbursement." So the law has given taxpayers the right to not pay other tax obligations to meet the reimbursement sum, forcing at the same time the tax administration to make compensation though deducting other obligations to meet the VAT amount requested for reimbursement. Meanwhile, Instruction 24/2008 "On tax procedures" restricts this right only when the tax administration has a conducted VAT audit and approved the amount of VAT reimbursable. That de facto limits the right of the taxpayer to avoid paying other tax liabilities. Thus, Article 75/1 of the law becomes unenforceable and the spirit of the law has been ignored. This is because in this way

So the law has given taxpayers the right to not pay other tax obligations to meet the reimbursement sum, forcing at the same time the tax administration to make compensation though deducting other obligations to meet the VAT amount requested for reimbursement.

the tax administration delays (*whether on purposely or not*) performing tax audit in the 30-day window (as happened in this case) and nevertheless continues

to demand payment of other tax liabilities from the taxpayer. The new agreement between the tax and customs administrations. Media outlets have made public the fact that the tax and customs administrations have reached an agreement which mandates that if a company owes money to the tax administration, the customs administration will block the company from performing customs procedures. The information was confirmed by the Director General of Taxation at the Business Forum. AmCham members asked for information on the legal basis of stopping customs procedures.

The Law "On Tax Procedures" recognizes the right of the tax administration to exchange information with other administrations, but not the right to block a public service by these administrations.





Sistemi i ri informatik nuk mundëson deklarimin dhe pagesën e tatimit nga individët e huaj për të ardhurat e gjeneruara në Shqipëri

Me implementimin e sistemit të ri informatik të administratës tatimore, çdo pagesë për këtë administratë kryhet vetëm me urdhër pagesën përkatëse të printuar nga sistemi online. Sipas Udhëzimit të Ministrit të Financave, individët e huaj që duhet të paguajnë tatim në Shqipëri duhet të paraqiten pranë Drejtorive Rajonale Tatimore, me qëllim mundësimin e regjistrimit në sistemin informatik për të kryer pagesën e detyrimeve tatimore. Aktualisht, në Drejtoritë Rajonale Tatimore nuk mundësohet një regjistrim i tillë, pra nuk është e mundur pagesa e detyrimeve tatimore. Përveç mungesës së të ardhurave në buxhetin e shtetit, kjo përbën edhe shqetësim për individët, për vonesën e pagesës dhe penalizimin më vonë për këtë.

Po ashtu, shqetësim përbën edhe mënyra e pagesës së këtyre tatimeve. Në legjislacionin tatimor parashi-

kohet pagesa e detyrimeve tatimore, të cilat nuk janë subjekt i mbajtjes së tatimit në burim në datën 20 të muajit që pason muajin kur kryhet pagesa, ndërsa në sistem është parashikuar vetëm deklarimi vjetor.

Shembull i problematikës së dispozitave të udhëzimit të Ministrisë së Financave tej parashikimeve të ligjit:

Neni 75/1 i ligjit nr. 9920 “Për procedurat tatimore” përcakton se “Nëse personat e tatueshëm, të regjistruar për TVSH-në, rezultojnë me teprice kreditorë dhe paraqesin pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore kërkesën për rimbursimin e TVSH-së së paguar tepër, administrata tatimore, brenda 60 ditëve kalendrike (30 ditë për eksportuesit), verifikon saktësinë e pretendimit, njofton tatimpaguesin dhe realizon rimbursimin, kur plotësohen kushtet. Në rast të kundërt, personit të tatueshëm i lind e drejta e mospagesës së detyrimeve të tjera tatimore, në masën e TVSH-së së pretenduar për rimbursim.

Pra, ligjvënësi i ka dhënë tatimpaguesit të drejtën që të mos paguajë detyrime të tjera tatimore, duke e detyruar në të njëjtën kohë administratën tatimore, të bëjë kompensim të detyrimeve të tjera tatimore deri në shumën e TVSH-së së kërkuar për rimbursim.

Ndërkohë, Udhëzimi nr. 24/2008 “Për procedurat tatimore” e kufizon këtë të drejtë vetëm në rastin kur administrata tatimore ka kryer kontrollin e TVSH-së dhe e ka miratuar shumën e TVSH-së si të rimbursueshme. Kjo gjë kufizon de facto të drejtën që ka tatimpaguesi, për të mos paguar detyrimet e tjera tatimore. Në këtë mënyrë, neni 75/1 i ligjit bëhet i pazbatueshëm dhe nuk realizon qëllimin e ligjvënësit. Kjo pasi në këtë mënyrë, administrata tatimore vonon (me qëllim ose jo) kryerjen e kontrollit tatimor përtej afatit 30-ditor (siç ka ndodhur në rastin konkret) dhe megjithatë vazhdon të kërkojë pagesën e detyrimeve të tjera tatimore nga tatimpaguesi.

Marrëveshja e re ndërmjet administratës tatimore dhe administratës doganore

Media ka informuar publikun se administratat tatimore dhe doganore kanë lidhur një marrëveshje, ku ndër të tjera parashikohet se nëse kompania është debitorë kundrejt administratës tatimore, administrata doganore do të bllokojë kryerjen e procedurave doganore të mallrave. Ky informacion u konfirmua edhe nga Drejtoresha e Përgjithshme e Tatimeve. Anëtarët e Dhomës kërkuar të informohen mbi bazën ligjore që parashikon mundësinë e bllokimit të procedurave doganore.

Ligji “Për procedurat tatimore” i njeh të drejtën administratës tatimore, të shkëmbejë informacion me administratat e tjera, por jo të drejtën e bllokimit të shërbimeve publike nga këto administrata.

Pra, ligjvënësi i ka dhënë tatimpaguesit të drejtën që të mos paguajë detyrime të tjera tatimore, duke e detyruar në të njëjtën kohë administratën tatimore, të bëjë kompensim të detyrimeve të tjera tatimore deri në shumën e TVSH-së së kërkuar për rimbursim.

The obligation to include the liquidator in the payroll of the company in liquidation

Instruction 26, dated April 4, 2009 “On the collection of compulsory social security and health insurance” provided that any legal person registered for VAT, must declare at least one employee, which normally is also its legal representative, and for whom the company must pay mandatory contributions to social security and health insurance. Following that instruction, the Technical Decision of the Directorate General of Taxation No. 5/k, dated July 13, 2011 “Some clarification regarding contributions to social insurance and health” established that the company’s liquidator is also a professional that must be registered with the tax authorities as a registered accounting expert, for example. Performing the function of a liquidators cannot be treated as an outside service and billed by a registered taxpayer to the tax authorities but should be instead done by someone considered as employed in the company in liquidation and must thus pay compulsory contributions for social and health insurance, according to the same rules as for employees in companies under normal businesses activity.

Despite the fact that Instruction 26 has been repealed, and the new instruction does not mandate such a request, the tax administration information system is built in a way that doesn’t allow the declaration of social and health insurance payments in another way (payroll also serves as a statement).

This also applies to the liquidators or administrators of companies in bankruptcy proceedings, bringing on an absurd situation where a liquidator, which acts as a freelancer, has to be declared as employed in many companies. AmCham emphasizes that the companies in liquidation are not considered as having no activity (the liquidator sells remaining assets of the company and collects obligations) and there is no reason to treat it as such. Also, to avoid any uncertainty, the Directorate General of Taxation should issue a new technical decision on the matter, members noted.



NEW VAT INSTRUCTION FOR SPECIAL REGIME ON CIGARETTES

In the Draft Instruction, without any legal basis and no procedures and practical application possibilities, responsibility is set on the “main supplier” (importer) to “force” thousands of intermediate suppliers and retailers across the country, that when they change the price (due to the increase in the excise) to report to the main supplier the quantity of cigarettes left (in stores or warehouses of distributors and retailers) and the latter (the main supplier) has to then calculate, declare and pay VAT on the part of the price that has increased for the part of leftover goods after the date of the price change. The question is how can the main supplier administer such control and force thousands of taxpayers to do a physical inventory on the date of the price change? How can the main supplier administer it, at a time when the importer serving as main supplier sells all the goods to a single (or several) distributor(s) and has no ties to the thousands of taxpayer retailers? Such demand simply cannot be administered by the main supplier (importer). It is unmanageable because it assigns the functions of control that are outside the legal framework and the nature of its business. In practice, this simply will be abused or misused (Small amounts will be reported, or none at all). If the taxpayer is forced to perform a procedure, it should be set up in a way that it can administer it at minimal cost. The major importers (in the case of cigarettes) sell their entire product quantity to distributors, and the latter are in charge of relations with getting the product to the retailers. The main importer has no business relations with thousands of vendors nationwide. It is the duty of the Regional Tax Offices to oversee prices and use proper documentation such as cash register data throughout the retail network to make every taxpayer take care of their responsibilities in maintaining documentation on observation of prices and tax payments.



Detyrimi për përfshirjen e likuidatorit në listëpagesën e shoqërisë në likuidim e sipër

Udhëzimi nr. 26, datë 16.04.2009 “Për mbledhjen e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore” parashikonte se asnjë person juridik i regjistruar në TVSH, nuk mund të mos deklarojë, minimumi një person të punësuar, që normalisht është përfaqësuesi ligjor i tij, për të cilin shoqëria duhet të paguajë kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore e shëndetësore.

Në vijim të tij, Vendimi Teknik i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve nr. 5/k, datë 13.7.2011 “Disa sqarime lidhur me kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore” përcaktonte se edhe në rastet kur likuidatori i

emëruar i shoqërisë është një profesionist i regjistruar në organet tatimore si p.sh. ekspert kontabël i regjistruar, etj., kryerja e funksionit të likuiduesit nuk mund të trajtohet dhe të faturohet si një shërbim i kryer nga një tatimpagues i regjistruar në organet tatimore, por duhet të konsiderohet si i punësuar në shoqërinë në likuidim dhe të paguajë kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, sipas të njëjtave rregulla si për të punësuarit në subjektet që janë në aktivitet ekonomik.

Pavarësisht se Udhëzimi nr. 26 është shfuqizuar, dhe Udhëzimi i ri nuk parashikon një kërkesë të tillë, sistemi informatik i administratës tatimore është i ndërtuar në mënyrë të tillë që nuk mund të bëhet deklarimi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore (listëpagesa shërben edhe si deklaratë). Kjo vlen edhe për likuidatorët apo administratorët e shoqërive në falimentim, duke sjellë situata absurde ku një likuidator, i cili vepron si profesionist i lirë, duhet të deklarohej si i punësuar në shumë shoqëri. Thëksojmë se, shoqëritë në likuidim nuk konsiderohen si pa veprimtari (likuidatori shet aktivet e mbetura të shoqërisë dhe mbledh detyrimet) dhe nuk ka kuptim një trajtim i tillë. Gjithashtu, për të shmangur çdo paqartësi, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve duhet të shprehet me një vendim të ri teknik lidhur me këtë çështje.

UDHEZIMI I RI I TVSH-SË, PER REGJIME TE VECANTA PER CIGARET

Në Projekt Udhëzim, pa asnjë baze ligjore dhe asnjë procedure dhe mundësi praktike zbatimi, ngarkohet me përgjegjësi “Furnizuesi kryesor” (importuesi) që “te detyroje” mijera furnizues te ndermjetem dhe shitesa me pakice ne te gjithë vendin, qe ne raste ndryshimi cmimi (per shkak te rritjes se akcizes) t’i raportojne “Furnizuesit kryesor” gjendjen e mallit cigare (ne dyqanet apo magazinat e distributorëve dhe shitësave me pakicë) dhe ky i fundit (Furnizuesi Kryesor) te llogarisë, deklarojë dhe paguajë TVSH-në per pjesën e rritur të çmimit per mallin gjendje ne daten e ndryshimit të çmimit.

Cështja qëndron sesi mundet “Furnizuesi kryesor” të kontrollojë dhe detyrojë dhjetra apo mijëra tatimpagues që të bëjnë inventarë fizike datën e ndryshimit të çmimit? Si mundet “Furnizuesi kryesor” ta administrojë një gjë të tillë, në një kohë që Furnizuesi kryesor të gjithë sasinë e importuar ia shet një distributori të vetëm (ose disave) dhe nuk ka asnjë lidhje me mijëra tatimpagues, shitës me pakicë? Një kërkesë e tillë është absolutisht e pa administrueshme nga furnizuesi kryesor (importuesi), dhe i ngarkon atij funksione kontrolli që nuk ia lejon ligji dhe nuk janë në natyrën e biznesit të tij. Në praktikë, kjo thjesht do të abuzohet apo keqpërdoret (do raportohen sasi të vogla ose fare).

Nëse i ngarkohet tatimpaguesit një procedurë, duhet të shihet edhe mundësia që ai ka ta administrojë atë me kosto minimale. Importuesit kryesorë (ne rastin e cigareve) ia shesin të gjithë prodhimin distributorëve dhe janë këta të fundit që i kanë marrëdhëniet me pikat e shumicës dhe të pakicës. Importuesi kryesor nuk ka asnjë lidhje biznesi me mijëra shitës në mbarë vendin. Është detyrë e Drejtorive Rajonale Tatimore të kontrollojnë zbatimin e cmimeve dhe përdorimin e dokumentacionit të duhur dhe kasave fiskale në të gjithë rrjetin me pakicë, dhe cdo tatimpagues është i detyruar të ketë përgjegjësitë e veta në mbajtjen e dokumentacionit, respektimin e cmimeve, dhe pagesën e tatimit.



Customs Director Spiropali discusses procedures and legal changes with AmCham businesses

Reference prices and excise duties lead discussions

The American Chamber of Commerce in Albania started its new working year with the traditional meeting of its members with the head of the country's customs administration. Customs Director General Elisa Spiropali joined the meeting with members of her technical staff to discuss issues AmCham businesses continue facing at customs points.

AmCham has an open dialogue with the Customs Directorate and as part of its cooperation philosophy, the development of this institutional dialogue serves not only to solve issues, but also to positively influence the creation of a sustainable business climate.

During the meeting, AmCham introduced Customs Director Spiropali with some of the key issues reported as barriers by AmCham members. The head of the Tax and Legal Committee at AmCham, Mr. Artan Bozo briefed Director Spiropali on some of these issues. AmCham has been informed by its members of the application of reference prices even in cases of original purchase paperwork for products coming from the U.S or Canada, although it has been agreed this issue will be given a solution.

"I would suggest that in case of bills issued by

American companies, there should be no thinking that 'there is something in here, there is need for intervention and reference prices should apply.' It is lost time and an unfair punishment," said Trifon Murataj, an attending businessman.

Regarding this issue, the customs administration representatives said "if we lift the reference price regime all at once, then we will have problems with unverifiable bills from countries which don't allow the exchange of information."

Mrs. Spiropali added: "But, there are countries, for which our priority is to fully abandon the use of assessment methods or reference prices such as the U.S or the EU." AmCham members also raised the issue of excise duties coming from the customs system and have to be paid in customs points. As far as the implementation of the law is concerned, the ordinances on the Customs Code were passed without taking into consideration the business community's requests.

"Much has been talked about the work being carried out on the drafting of the by-laws, but the business community was introduced to them only last December, being deprived of the necessary time for discussion," said Mr. Bozo.

Referring to business concerns over the refundable excise duty, Spiropali said all cases submitted to the Albanian customs administration have been cleared.

Drejtorja e Doganave Spiropali flet me biznesin e AmCham për procedurat dhe ndryshimet ligjore

Referencat dhe akcizat në qendër të diskutimit

Dhoma Amerikane e ka filluar vitin e ri të punës me takimin tradicional të anëtarëve të saj me Drejtorin e Doganave. Elisa Spiropali ka ardhur së bashku me stafin e saj teknik, për t'u përballur me çështjet që biznesi i Dhomës Amerikane vazhdon të hasë në traun doganor.

Dhoma Amerikane ka një dialog të hapur me Drejtorinë e Doganave dhe në filozofinë e saj të bashkëpunimit, zhvillimi i këtij dialogu institucional jo vetëm që i shërben zgjidhjes së problematikave, por ndikon pozitivisht dhe në krijimin e një klime të qëndrueshme biznesi. Gjatë takimit, Dhoma Amerikane e njohu Drejtorin e Doganave, znj. Spiropali, me disa nga çështjet themelore, të cilat janë raportuar si problematika në Dhomën Amerikane. Kryetari i Komitetit të Taksave dhe Ligjeve, z. Artan Bozo, e njohu shkurtimisht Drejtorin Spiropali me disa prej tyre. Kështu, anëtarët na kanë informuar se aplikohen çmime reference madje edhe në rastet kur ka fatura të rregullta të produkteve që vijnë nga Amerika apo Kanadaja, megjithëse është rënë dakord që ky problem do të zgjidhet.

“Do të sugjeroja që për një faturë të lëshuar nga kompanitë amerikane, të mos ketë as-



një lloj mendimi se ‘këtu ka diçka, duhet ndërhyrë dhe duhet çuar në referencë’. Është kohë e humbur dhe një ndëshkim i padrejtë”, deklaroi biznesmeni Trifon Murataj. Në lidhje me këtë çështje, Drejtorja e Doganave ka deklaruar se “nëse ne do t'i hiqnim sot tërësisht, atëherë do kishte probleme me fatura të paverifikueshme nga vende që nuk lejojnë shkëmbimin e informacionit. Por ka vende, për të cilat ne kemi prioritet zerimin e përdorimit të metodave të vlerësimit apo referencave, si për SHBA-të apo BE-në”, deklaroi nga ana tjetër drejtoresha e Doganave, znj. Elisa Spiropali. Një tjetër çështje e ngritur në takim prej anëtarëve, ka qenë edhe ajo e akcizave që vijnë nga sistemi doganor dhe duhen paguar në dogana. Gjithnjë duke mbetur tek zbatimi i ligjit, udhëzimet e Kodit Doganor kanë kaluar pa u marrë në konsideratë edhe kërkesat e biznesit. “Është folur shumë për punën që po bëhet për hartimin e dispozitave ligjore, biznesit iu bë e mundur që të njihet me to vetëm në dhjetor, pa i lënë kohën e nevojshme për diskutim”- tha gjatë takimit kryetari i KTL-së, z. Bozo.

Referuar shqetësimit të bizneseve mbi akcizën e rimbursueshme, Spiropali tha se janë likujduar të gjitha rastet e paraqitura pranë doganës shqiptare.



The detailed procedures to enable the implementation of the Customs Code by-laws which entered into force on January 1, 2015 regarding:

- » Authorized Economic Operators (AEO);
- » Simplified Procedures;
- » New exemptions from customs duties/privileged operations;
- » Considerable reduction in the number of inspections;
- » How can one apply for AEO status?
- » The application, in writing or electronically based on the standard format (Government Decision 919/2014);
- » Accompanied by a self-assessment questionnaire - filled in correctly;
Z. Olindo Shehu Partner Drejtues dhe Partner për Çështjet Ligjore dhe të Taksave në Deloitte Albania dhe Kosova parashtroi disa nga karakteristikat e këtij ligji. Sipas Z. Shehu ky ligj i ri përbën një faktor lehtësues dhe tërheqës për investitorët e huaj, veçanërisht ata të vendeve anëtare në BE që vendosin të investojnë në Shqipëri. *“Këta investitorë do të mund të planifikojnë lirisht shitblerje mallrash e shërbimesh përtej kufijve shqiptare, duke qenë të sigurt që trajtimi i këtyre transaksioneve për efekte të TVSH-së do të jetë i përafëruar me trajtimin sipas Direktivës së BE-së.”* – tha Olindo Shehu. Sipas Z. Shehu, legjislacioni i ri sjell avantazhe të shumta si për kompanitë shqiptare dhe të huaja që operojnë në vend, por edhe për ekonominë shqiptare. *“Ky legjislacion do të sigurojë një zbatim më uniform të rregullave të TVSH-së.”* – tha Z. Shehu, – *“Ky ligj do të pakësojë mundësitë për keqinterpretim apo abuzim, për shkak se tashmë, mund t’i bëhet referencë një praktike shumëvjeçare të shteteve të BE-së dhe mund të merren për bazë vendimet e Gjykatës Europiane të Drejtësisë të lidhura me TVSH-në.”* – shtoi ai. Këto të fundit sipas Shehut, edhe pse nuk janë ende detyruese për Shqipërinë për sa kohë nuk është ende anëtare e BE-së, përbejnë një bazë reference që pritet të jetë gjerësisht e pranuar nga autoritetet tatimore dhe gjyqësore në Shqipëri.

Znj. Iris Toto, Senior Manaxhere pranë Deloitte Albania dhe specialiste për Direktiven Europiane mbi TVSH-në, ilustron përmes rasteve konkrete studimore praktike për bizneset e pranishme duke shpjeguar në detaje se si legjislacioni i ri prek transaksione të caktuara në disa industri. Shpjegimet e saj u pasuruan nga shembujt konkretë që solli për të pranishmit Znj. Enkeleida Pipa, përfaqësuese e ekipit të Tatimeve Indirekte, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Enkeleida, e cila mbajti gjithashtu një prezantim të fokusuar në ndryshimet më të mëdha që sjell ky legjislacion, përmes shembujve realë dhe të detajuar.

FREE ZONES

Free zones policy is becoming increasingly more popular for governments seeking to attract foreign investments, promote export-oriented growth, and generate employment.



Loreta Peçi
PricewaterhouseCoopers (PwC)* Albania

Free zones are special areas within the customs territory of a country in which companies enjoy tax benefits, state aid on investments, preferential customs treatments as well as simplified administrative procedures. In return, the companies having permission to operate in free zones should attract foreign capital, increase employment, provide new technology as well as contribute in the economic restructuring of the country. Free zones are established through government approval and are regulated by a special law on free zones, which prevails from similar provisions in any other law.

Free zones are mainly characterized by customs duties facilities therefore it is natural that free zones are usually placed near customs borders, ports, or airports. Free zones are distinguished by operating companies developing and providing high technology, telecommunication, industry and logistics, modern manufacture, tourism, export related services, etc. It is also preferred that companies established in free zones operate in a new industry such that there is no distortion of competition regarding other companies already operating in the market.

While operating in free zones, these companies can benefit from incentives in corporate income tax ("CIT"), personal income tax ("PIT"), value added tax ("VAT"), customs duties etc. For instance, free zones established in Macedonia provide for 0% CIT, PIT, VAT on trades and 0% customs duties on import in the zone. Further, free zones in Serbia provide for a period of five years of tax holidays, VAT and customs duties exemptions, significant reduction of tax payable as well as effective tax administration (through the establishment of one stop shop). Both the illustrative countries above, also offer to contribute in expenditures in case companies fulfil various criteria (i.e. invest a certain amount of capital; create new employment opportunity, etc.).

Establishing free zones – What to consider

The World Bank Report in 2008 states that zones have been effective in addressing economic growth and

development objectives, but they have not been uniformly successful. It is very important that policy frameworks is designed to encourage zones to compete on the basis of facilities and services rather than on the basis of fiscal incentives.

In addition, free zones should be projected and in line with the program of the ruling government. For instance, if a certain program is focusing on existing businesses, tourism, farming, increasing the state budget

most probably the idea of free zones will be withheld. However, if a government is investing in increasing foreign investments, employment, or increasing the impact of vocational schools, then free zones might be favored.

In developing a relevant policy framework for zone programmes, guidelines should be considered. For instance, when designing a zone programme, governments should set realistic expectations and conduct a thorough cost/benefit analysis; free zones should respect the principle of non-discrimination between foreign and domestic investment projects; collaborative relationships should be encouraged between investment projects in the zones and firms and research institutions in the local economy, etc.

In return, in offering incentives, the government should follow guidelines such as generous fiscal incentive packages; a common set of incentives for all free zones operating in the country; ensure the link between fiscal incentives to actual process of capital formation and economy improvement.

It is very important, however, to consider the difficulties encountered while implementing free zones. The implementation of free zones has proved to be limited on different occasions, sometimes leading to the failure of these initiatives. A research from the World Bank has concluded that one of the reasons that make these zones inefficient is poor site location. It has been noticed that locations far from infrastructure lead to heavy capital expenditures, making the zones unattractive for investors.

Furthermore, cumbersome procedures and controls have been experienced previously. For example, let us consider the case of Ukraine where because of the lack of this control, the Ukrainian Vice-Premier Kozachenko estimated that one fifth of all meat sold in Ukraine was smuggled through the special zones. Most of it is unfit for human consumption.

Additionally, a main setback is the coordination between the government, free zones and existing businesses in a

ZONAT E LIRA



Politikat e zonave të lira sa vijjnë po bëhen më të famshme për qeveritë që synojnë rritjen e investimeve të huaja, nxitjen e eksporteve si edhe rritjen e punësimit.

Zonat e lira janë zona të caktuara brenda territorit doganor të një shteti, në të cilat shoqëritë përfitojnë lehtësira fiskale, subvencione për investimet, trajtime doganore preferenciale dhe procedura të thjeshtuara administrative. Në këmbim, shoqëritë që operojnë në këto zona tërheqin investime të huaja, rrisin punësimin dhe sjellin teknologji të reja duke kontribuar në rritjen dhe ristrukturimin e ekonomisë. Zonat e lira krijohen me miratimin e qeverisë dhe rregullohen nëpërmjet një ligji të përcaktuar veçanërisht për zonat e lira, nën të cilin mbizotërojnë mbi nenet e ngjashme në ligje të tjera.

Zonat e lira ofrojnë një serë lehtësirash doganore, dhe për pasojë gjenden zakonisht afër kufijve doganorë, aeroporteve dhe porteve detare. Shoqëritë që operojnë në zonat e lira janë prijëse të teknologjisë, telekomunikacionit, industrisë dhe logistikës, prodhimit modern, turizmit dhe shërbimeve të tjera të lidhura me eksportin. Gjithashtu, preferohet që shoqëritë që operojnë në këto zona, të operojnë në një industri të re në mënyrë që të mos krijohet konkurrencë e pabarabartë me shoqëritë të tjera jashtë zonës të cilat operojnë në të njëjtën industri.

Gjatë operimit në këto zona, shoqëritë mund të përfitojnë nga lehtësira në tatimin mbi fitimin (TF), tatimin mbi të ardhurat personale (TAP), tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSH), detyrimet doganore, etj. Për shembull, zonat e lira në Maqedoni i nënshtrohen një regjimi 0% për secilën nga taksat e sipërpërmendura si edhe 0% taksa doganore për importin në zonë. Më tej, zonat e lira në Serbi ofrojnë një periudhë 5 vjeçare pa taksa, përjashtime nga TVSH dhe nga detyrimet doganore, ulje të ndjeshme në taksat e pagueshme si edhe një administrim efikase të taksave (nëpërmjet vendosjes së një "one stop shop").

Të dy shtetet e përmendura më lart, kontribuojnë gjithashtu në shpenzime në rast se shoqëritë përmbushin një sërë kriteresh (pra, investojnë një sasi të caktuar kapitali; krijojnë vende pune të reja, etj.)

Krijimi i zonave të lira – Çfarë duhet konsideruar

Banka Botërore, në një raport të publikuar në 2008 shpreh se zonat e lira kanë qenë efikase në rritjen

ekonomike dhe në arritjen e objektivave të zhvillimit, por suksesi i tyre nuk ka qenë uniform. Është e rëndësishme që përpilimi i politikave për këto zona të jetë i tillë që të nxisë konkurrencën e këtyre zonave me shërbime dhe jo nëpërmjet lehtësirave fiskale.

Gjithashtu, zonat e lira duhet të projektohen sipas politikave të shtetit qeverisës. Për shembull, nëse politikat e një shteti synojnë rritjen e bizneseve ekzistuese, turizmit, bujqësisë dhe rritjes së buxhetit, atëherë koncepti i zonave të lira mund të ndalet për mungesë përshtatshmërie. Por, nëse synimi i qeverisë është të nxisë investimet e huaja, të rrisë punësimin, të përmirësojë efektin e arsimit profesional, atëherë krijimi i një zone të lirë mund të konsiderohet si një ide e favorshme.

Ndërtimi i zonave të lira duhet të shoqërohet me studime të sakta dhe të detajuara. Për shembull, gjatë hartimit të programit të një zone të lirë qeveria duhet të përcaktojë qëllime realiste dhe të kryejë një analizë të saktë të kostove dhe përfitimeve të kësaj zone. Politikat për zonat e lira nuk duhet të bëjnë dallime mes investimeve të huaja dhe atyre vendase; ato duhet të nxisin marrëdhënie bashkëpunuese midis investuesve të huaj dhe bizneseve vendase.

Në këmbim, në krijimin e lehtësirave, qeveria duhet të ndjekë një sërë parametrash si: paketa fiskale nxitëse, një set të përbashkët lehtësirash për të gjithë zonat e lira që veprojnë brenda vendit, si edhe duhet të sigurojë që paketat fiskale nga të cilat përfitojnë zonat e lira kanë një lidhje të shëndetshme me procesin e formimit të kapitaleve dhe përmirësimit të ekonomisë vendase.

Është shumë e rëndësishme të merren në konsideratë edhe vështirësitë që mund të shfaqen gjatë zbatimit të zonave të lira. Zbatimi i zonave të lira ka rezultuar i limituar në disa raste duke shkaktuar dështimin e këtyre nismave. Një studim nga Banka Botërore tregon se një nga arsytet që i bënë këto nisma jo-efikase është zgjedhja e gabuar e vendndodhjes së zonave. Është vënë re se vendosja larg zonave me infrastrukturë sjell shpenzime të larta kapitale, të cilat i bëjnë zonat jotërheqëse për investitorët.

Procedura dhe kontrolle të shumta të pavolitshme kanë qenë pjesë e përvojave të mëparshme të pasuksesshme të zonave të lira. Ukraina është një shembull i kësaj përvoje ku, sipas zv. kryeministrit Kozachenko, mungesa e procedurave të kontrollit, bëri të mundur që një e pesta e mishit të shitur në Ukrainë të ishte kontrabandë e futur nga zonat e lira. Pjesa më e madhe e këtij mishi nuk ishte e përshtatshme për konsum nga njerëzit.

Në vijim, një tjetër aspekt që shkakton pengesa është mungesa e koordinimit mes qeverisë, zonave të lira dhe bizneseve ekzistuese. Një koordinim i dobët midis bizneseve dhe qeverisë ka rezultuar dëmtes për këto

country. Weak coordination between private developers and governments has proven to be counterproductive for the purpose of these zones. This was clearly evidenced in Ukraine, when inequalities were created between different regions, where regions with economic free zones were flourishing faster than other regions. This is not beneficial for the overall goal of the economy, which is to grow as a whole. Consequently causing free zones to back fire the initial objective and costs of incentives offered.

Free zones legislation and practice in Albania

Currently there is a free zone in Vlorë, established by Decision of Council of Ministers No.628, dated 11.06.2009, and lately even a free zone in Durrës, established by Decision of Council of Ministers No.72, dated 28.01.2015. Pre-determined activities such as portal, industrial, manufacture, trading and storing goods, as well as any other service except from the production of steel are conducted in the zones. The free zones have been granted their status for 35 years, meaning that free zone Vlorë will cease in 2044, whereas free zone Durrës in 2050.

The legislation guiding free zones in Albania is Law No.9789, dated 19.07.2007 “On the implementation and operation of economic zones” (“Law on Economic Zones”). As determined in this law, economic zones (free zones and industrial parks) aim to increase investments; create new employment opportunities; promote regional development and broaden economic relations of the Albanian and foreign markets; implement advanced technology; increase the circulation of goods and capital. In return for the above mentioned contributions, Law on Economic Zones provides for no customs and VAT liabilities for companies operating in an established free zone in Albania, whereas industrial parks do not benefit from these incentives.

However, based on amendments suggested to Law on Economic Zones, incentives like exemption from payment of CIT for the first five years and reduction of CIT liability to 50% for the five consecutive years are included. Moreover, the amendments provide for facilities even for industrial parks such as the exemption from VAT of supply of raw materials in the building of the infrastructure and related equipment, and exemptions from real estate obligations for a period of five years to the establisher of the zone. Nonetheless, the amendments to Law on Economic Zones remain draft to the moment.

In the light of the above, even though there is a special legislation regulating economic zones (including free zones), both the practice and the legislation are limited in comparison to other neighbor countries.

Benefits of free zones to the Albanian economy

Functional free zones would help achieve some government goals as well as have a positive impact on the economy in general.

As previously mentioned, free zones contributes in numerous benefits in the economy of a country, especially for a developing country like Albania.

Based on the National Strategy for Development and Integration, one of the main strategic objectives regarding the economy is to increase the productivity and competition through the dynamic development of entrepreneurship, competitiveness better allocation of natural, human and financial resources. Furthermore, the main objective of the Albanian government regarding industrial policies is the stimulation of programs and projects that increase investments in technology, competitiveness in modernization, diversification and specialization in open markets.

On the other hand, from the experience of our neighbor countries with fully operating free zones, companies operating in it, being large producing companies, contribute in opening numerous new jobs requiring professional technical knowledge. As published in the political program of the Albanian government, one of the greatest challenges of Albania is the increase of professional capacities in order to attract funds from the European Union and increase investments.

Free zones would allow the government to be closer to the achievement of the goals through the adaptation and implementation of professional school programs according to the technical requirements of such professions.

Consequently, a fully operating free zone in Albania with the original impact of the creation of new jobs may result in the considerable increase of technical professionals, integration of professional schools with the actual requirements of the market, attraction of new funds in Albania.

As a result, Albania can benefit from the introduction of new technologies, increase of foreign investments, better use of national resources, etc. which may ultimately change the quality of living in Albania.

Therefore, we are looking at a potential increase in the general national product and at reaching important milestones that the Albanian government is ultimately working hard to achieve at the opportunity cost of the effect in the state budget from the incentives offered.

Developing free zones will also facilitate the achievement of strategic objectives set by the government. However, in reality the choice for governments is never as clear cut, since the goals are not explicitly characterized in favor or against the concept of free zones. Consequently, a compromise must be achieved.

To conclude, at this point of the development of Albania, the concern is whether Albania is willing to improve the operation free zones under the current economic conditions and political program, and mostly, whether the country can afford a more incentive free zone operation.

**PwC helps organisations and individuals create the value they're looking for. We're a network of firms in 157 countries with more than 195,000 people who are committed to delivering quality in assurance, tax and advisory services.*

Find out more by visiting us at www.pwc.com.

zona. Shembulli perfekt i kësaj është Ukraina ku u krijuan pabarazi të shumta midis rajoneve të ndryshme, ku rajonet me zona të lira ekonomike përjetuan një rritje ekonomike më të shpejtë se rajonet e tjera. Kjo nuk sjell përfitime për qëllimin kryesor të ekonomisë, që është një rritje në tërësi. Për rrjedhojë, zonat e lira kundërvepruan me objektivat fillestare si edhe me kostot e lehtësirave të ofruara.

Legjislacioni dhe praktika për zonat e lira në Shqipëri

Momentalisht, në Shqipëri ekziston një zonë e lirë në Vlorë, e krijuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 628, datë 11.06.2009, si edhe së fundmi një zonë e lirë në Durrës, e krijuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr.72, datë 28.01.2015. Në zonat e lira lejohen kryesisht aktivitetet portuale, industriale, prodhimtari, magazinim dhe tregti të produkteve dhe shërbimeve me përjashtim të atyre të lidhura me prodhimin e çelikut. Zonat e lira gëzojnë statusin për 35 vite, pra, zona e lirë në Vlorë do të pushojë së ekzistuari në vitin 2044, ndërsa zona e lirë në Durrës në 2050.

Ligji që rregullon zonat e lira në Shqipëri është ligji nr. 9789, datë 19.07.2007 “Mbi krijimin dhe funksionimin e zonave ekonomike” (“Ligji për Zonat Ekonomike”). Siç parashikohet në këtë ligj, zonat ekonomike (të cilat përfshijnë zonat e lira dhe parqet industriale) synojnë rritjen e investimeve, krijimin e vendeve të reja të punës, zhvillimin e zgjerimin e marrëdhënieve të Shqipërisë me tregjet e huaja, shfrytëzimin e teknologjive të avancuara dhe rritjen e qarkullimit të produkteve dhe kapitaleve. Në shkëmbim të kontributeve të lart përmendura, ligji për Zonat Ekonomike ofron 0% detyrime doganore dhe TVSH për shoqëritë që operojnë zonat e lira, ndërsa parqet industriale nuk përfitojnë nga këto lehtësira fiskale.

Megjithatë, ndryshimet e sugjeruara për ligjin për Zonat Ekonomike përfshijnë lehtësira si përjashtim nga pagesa e TF për pesë vitet e para dhe ulje të TF në 50% për pesë vitet e fundit. Gjithashtu, ndryshimet sugjerojnë lehtësira edhe për parqet industriale si përjashtim nga TVSH për furnizimin e materialeve të para për ndërtimin e infrastrukturës dhe makinerive, dhe përjashtime nga detyrime mbi pasurinë e paluajtshme për pese vite për krijuesin e parkut. Gjithësesi, ndryshimet mbeten në projektligj deri në këtë moment.

Për sa më sipër, edhe pse ekziston një legjislacion që qeveris zonat ekonomike (duke përfshirë zonat e lira), legjislacioni dhe praktika janë të limituara në krahasim me legjislacionin dhe praktikën e adoptuar nga shtetet fqinje.

Përfitimet e ekonomisë shqiptare nga zonat e lira

Zonat e lira funksionale do të ndihmonin në arritjen e disa prej qëllimeve të qeverisë duke sjellë gjithashtu një efekt pozitiv në ekonominë e vendit në tërësi.

Siç përmendet më lart, një zonë e lirë kontribuon me përfitime të shumta në ekonominë e një shteti, sidomos për një vend në zhvillim siç është Shqipëria.

Sipas Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim,

një nga objektivat kryesore strategjike të ekonomisë, është rritja e prodhimtarisë dhe konkurrencës nëpërmjet zhvillimit të sipërmarrjes, shpërndarjes më të mirë të burimeve njerëzore, natyrore dhe financiare. Për më tepër, objektiva kryesore e qeverisë shqiptare rreth politikave industriale është stimulimi i programeve dhe projekteve që rrisin investimet në teknologji, konkurrencën në procesin e modernizimit, diversifikimin dhe specializimin në tregjet botërore.

Nga ana tjetër, nga përvoja e shteteve fqinje me zona të lira në funksionalitet të plotë, shoqëritë që operojnë në këto zona duke qenë shoqëri të mëdha prodhuese, kanë kontribuar në hapjen e vendeve të shumta të punës të cilat kërkojnë njohuri profesionale teknike. Siç është publikuar edhe në programin politik të qeverisë shqiptare, një nga sfidat më të mëdha të Shqipërisë është rritja e kapaciteteve profesionale për të tërhequr fonde nga Bashkimi Evropian si dhe rritja e investimeve.

Zonat e lira do të bënin të mundur që qeveria të ishte më afër arritjes së qëllimit të saj për të hapur dhe adaptuar programe shkollash profesionale sipas kërkesave teknike të këtyre profesioneve.

Rrjedhimisht, një zonë e lirë me funksionalitet të plotë në Shqipëri me efektin ideal të krijimit të vendeve të punës mund të rezultojë në rritjen e konsiderueshme të profesionistëve teknikë, integrimin e shkollave profesionale me kërkesat aktuale të tregut, si dhe tërheqjen e fondeve të reja në Shqipëri.

Për pasojë, Shqipëria mund të përfitojë nga përdorimi i teknologjive të reja, rritja e investimeve të huaja, përdorimi më i mirë i burimeve njerëzore, etj., që mund të çojnë në rritjen e cilësisë së jetës në vend.

Pra, sipas kësaj politike do të bëhej e mundur një rritje potenciale në produktin e përgjithshëm kombëtar, dhe realizimi i objektivave të rëndësishme për të cilat qeveria shqiptare po punon me përkushtim, në krahasim me koston oportune në buxhetin e shtetit për lehtësirat fiskale të ofruara.

Zhvillimi i një zone të lirë do të lehtësojë gjithashtu arritjen e objektivave strategjike të vendosura nga qeveria. Megjithatë në realitet, zgjedhja nuk është kurrë kaq e lehtë, sepse qëllimet nuk janë të karakterizuara në mënyrë eksplicite pro apo kundra zonave të lira. Për rrjedhojë, duhet të arrihet një kompromis.

Për të përfunduar, në këtë stad të zhvillimit të Shqipërisë, pyetja që duhet të shtrojmë është nëse Shqipëria është e gatshme të përmirësojë veprimtarinë e zonave të lira nën regjimin politik dhe kushtet aktuale ekonomike, si dhe më e rëndësishmja, nëse shteti mund të përballojë një paketë me lehtësira fiskale në zonat të lira.

**PwC është një rrjet firmash që operojnë në 157 vende te botës me më shumë se 195,000 ekspertë të cilët ofrojnë shërbime cilësore profesionale në fushën e auditimit, taksave dhe konsulencës financiare.*

Për më shumë, na vizitoni në www.pwc.com.



AmCham members *Celebrate Holiday Season*

The end of the year and the Holiday Season has again brought members of the American Chamber of Commerce in Albania together to celebrate in a gala evening, which was also attended by U.S. Ambassador Alexander Arvizu.

The evening began with a smaller gathering of board members, sponsors and Ambassador Arvizu, where those attending discussed the business performance and the business climate in the country.

They were later joined by about 200 AmCham members who celebrated the coming of the New Year under the sounds of an Italian orchestra and décor. In his opening remarks, AmCham President Mark Crawford, welcomed the guests and Ambassador Arvizu, who was about to leave Albania after his departure at the end of his mandate had been delayed for months due to delays in Washington in confirming his successor.

“We have gathered two or three times believing it was a send-off [for Ambassador Arvizu], but I believe that this will be indeed the last meeting of this

kind with him here, and I want to take this opportunity to give him a symbolic gift on behalf of all members of the American Chamber of Commerce in Albania. Thank you for being here with us today. It was a year of charge for AmCham and for you. We have worked hard this year to help develop a sustainable business climate and making Albania more attractive for foreign investments,” Mr. Crawford said.

He gave the ambassador a mosaic created by renowned artist Myftar Cubi. Ambassador Arvizu thanked all members of AmCham and wished them success in their work. He then joined the year-end celebratory evening, which started with American music and continued with familiar melodies closer to Albania. During his speech, AmCham President Crawford presented a summary of the lobbying work AmCham had done during the year and the ambitious plan that the chamber plans for the new year.

“We tried this year to create a sustainable dialogue with the government, being part of all of the forums organized by the Economic Council and the Tax Council, as well organizing Business Forums with all the heads of the customs, tax and finance administrations,” Mr. Crawford said.

Anëtarët e AmCham *bashkohen për Festat e Fundvitit*

Festat e Vitit të ri kanë bashkuar sërish anëtarët e Dhomës Amerikane, të cilët kanë festuar së bashku me Ambasadorin Amerikan Aleksandër Arvizu. Mbrëmja ka filluar me një ceremoni të ngushtë të bordit dhe sponsorave të aktivitetit me Ambasadorin Arvizu, ku në qendër të diskutimeve ka qenë ecuria e biznesit dhe klima e të bërit biznes në vend.

Mbrëmjes i janë bashkuar më pas edhe rreth 200 anëtarë të Dhomës Amerikane, të cilët kanë festuar nën tingujt e orkestrës italiane dhe dekorit.

Presidenti i Dhomës Amerikane duke përshëndetur Ambasadorin Arvizu tha: “Ne jemi nisur ta përcjellim dy - tri herë, por besoj se ky do të jetë vërtet takimi i fundit, ndaj po përfitojmë nga rasti t’i japim një dhuratë simbolike në emër të të gjithë anëtarëve të Dhomës Amerikane. Faleminderit që jeni sot këtu me ne. Ka qenë një vit i ngarkuar për Dhomen Amerikane

dhe për ju. Kemi punuarë këtë vit për të ndihmuar në zhvillimin e një klime biznesi të qëndrueshme në vend dhe të favorshme për investimet e huaja” – është shprehur Presidenti i Dhomës Amerikane, Mark Kroford, duke i dhuruar një punim mozaikësh me gurë nga Myftar Cubi.

Ambasadori Arvizu ka falënderuar të gjithë anëtarët e Dhomës Amerikane, u ka uruar suksese në punën e tyre dhe i është bashkuar Mbrëmjes së Fundvitit, e cila ka filluar me muzikë Amerikane dhe ka vazhduar nën ritmin e melodive të njohura.

Gjatë fjalës së tij, Presidenti i Dhomës Amerikane i ka bërë një përmbledhje punës lobuese që ka bërë Dhoma gjatë vitit, përpjekjeve dhe planit ambicioz për vitin në vazhdim.

“Jemi përpjekur këtë vit të krijojmë një dialog të qëndrueshëm me qeverinë, duke qenë pjesë e të gjitha forumeve të ngritura prej saj nga Këshilli Ekonomik e Këshilli Tatimor dhe deri tek Forum Bizneset me të gjithë drejtuesit e institucioneve tatimore, doganore e fiskale” – tha z. Kroford.







SPONSORË





Floreta Luli-Faber

When an organization and its leader GROW together

Fifteen years ago, in a modest office and with 40 charter members, the American Chamber of Commerce began its journey in Albania. The organization was modest at first. Its staff was made up only of Executive Director Floreta Luli-Faber and an assistant.

But the chamber aimed to implement new ideas and ways of cooperating with businesses based on the successful formats that were in use for years by other AmChams, but which were then a novelty in the Albanian market. The challenge then was for the organization to uphold the good brand name AmCham had created across the world. Today, it has fully done so with integrity and professionalism, having prestige in the market. The fact that Floreta Luli-Faber was at the helm of the chamber's management of these meager resources, which later developed and grew, was not mere chance, but rather an integral component of the chamber's success. AmCham has grown and strengthened in Albania while staying faithful over the past 15 years to the principles on which it was set up to serve the business community and the investment climate in the country. The chamber has not based its work on individual interests. It has instead focused on fundamental sectorial issues, bringing expert opinion on issues that directly affect doing business in this country.

It has not been easy to protect the basic principles, increase membership numbers, organize activities to serve the members as well as bring together to the

same table business representatives and government officials to present arguments and problems.

The AmCham Board of Directors is made up of volunteers in charge with developing policies on which the chamber operates. These guidelines are then translated into the daily work of the chamber through fair and constructive relations its staff has built with members and collaborators. As AmCham marks its 15th anniversary in Albania, it is also for the first time changing its executive director. A new leader will have to take over from someone who, together with the staff, built over the years a strong reputation for the chamber wherever AmCham displayed its name and logo. Thanks to that dedication, discipline, proper management and communication skills, the American Chamber of Commerce in Albania is today a solid organization ready for future challenges and developments.

Floreta Luli-Faber brought during her 15 years as Executive Director of the American Chamber of Commerce her training and background in economics and marketing as well as her experience at a prestigious firm like Deloitte & Touche. Along with the organization she led, Floreta created a strong profile as a manager by intertwining the success of the organization with her own professional success.

In exchange, the organization offered Floreta the ability to grow as a leader and sharpen her communication skills. Now fully prepared to tackle her next professional challenge, Floreta Luli-Faber will have her time managing the American Chamber of Commerce as a fundamental and important part of her professional resume.

Floreta Luli-Faber

Kur organizata dhe lideri RRITEN së bashku



15 vjet më parë në një zyrë modeste dhe me një listë prej rreth 40 anëtarësh Dhoma Amerikane e Tregtisë filloi rrugëtimin e saj në Shqipëri. Modestia shkonte edhe më tej, kur stafi i përbërë vetëm nga Drejtorja Ekzekutive, Floreta Luli-Faber dhe një asistente duhet të implementonin forma dhe ide të reja të bashkëpunimit me biznesin, të njohura si formate të suksesshme tek Dhomat e tjera Amerikane, por një risi për tregun shqiptar.

Sfida që e priste organizatën që duhet të justifikonte edhe në Shqipëri emrin e mirë të krijuar kudo në botë, është sot realiteti i një organizate me prestigj, integritet dhe profesionalitet në treg.

Dhe jo rastësisht në krye të ekzekutivit të Dhomës, me përgjegjësinë më të madhe të menaxhimit të këtyre burimeve modeste që më pas u rritën dhe u zhvilluan, ka qenë Floreta Luli-Faber. Dhoma Amerikane është rritur dhe forcuar, duke ruajtur të pandryshuara në këto 15 vjet parimet mbi të cilat u ngrit, për t'i shërbyer komunitetit të biznesit dhe klimës së investimeve në Shqipëri, duke mos u angazhuar në interesa personale, por në çështje themelore sektoriale dhe duke sjellë mendimin e ekspertëve në çështje që prekin drejtpërdrejt aktivitetin e biznesit në vend.

Nuk ka qenë e lehtë që t'i qëndrosh këtij parimi, të rrisësh numrin e anëtarëve, të organizosh aktivitete që i shërbejnë atyre, duke ulur në të njëjtën tavolinë biznesin me autoritetet qeveritare dhe duke folur me argumente për problemet. Bordi i Drejtorëve që

ka punuar vullnetarisht dhe ka hartuar politikat mbi të cilat funksiononte Dhoma, i ka parë të përkthyer më së miri ato në punën e përditshme të Dhomës dhe në raportet e drejta dhe konstruktive që Dhoma ndërtoi me të gjithë bashkëpunëtorët e saj.

Në jubileun e 15-të, Dhoma ndryshon për herë të parë Drejtorin Ekzekutiv, duke pasur në memorien dhe historinë e ndërtuar gjatë këtyre viteve një emër që së bashku me stafin e vet e bëri të respektshëm emrin e Dhomës Amerikane dhe të kudo gjendur logon e saj. Falë përkushtimit, disiplinës, orientimit të drejtë menaxherial dhe aftësive komunikuese, Dhoma Amerikane është sot një organizatë solide, e gatshme për sfidat që i sjell koha dhe zhvillimet në vend. Floreta Luli-Faber, në 15 vjet të eksperiencës së saj si Drejtore Ekzekutive e Dhomës Amerikane, solli formimin e saj në ekonomi, marketing dhe eksperiencën e punës së një kompanie prestigjioze si Deloitte & Touché. Së bashku me organizatën, Floreta do të formonte profilin e saj si menaxhere, duke njehsuar suksesin e organizatës edhe si suksesin e saj profesional.

Në këmbim, organizata i dhuroi Floretës mundësinë për t'u formuar si një lider dhe për të sofistikuar aftësitë e saj në komunikim. Tashmë e përgatitur profesionalisht për hapat e rinj, Floreta Luli-Faber do të ketë në CV-në e saj, si një pjesë themelore dhe të rëndësishme drejtimin e Dhomës Amerikane të Tregtisë.



Dhoma Amerikane merr Çertifikatën e Meritës në Ditën Ndërkombëtare të Doganave

Dhoma Amerikane e Tregtisë është nderuar me “Çertifikatën e Meritës” nga Organizata Botërore e Doganave në Ditën Ndërkombëtare të Doganave.

Çmimi është dhënë nga Drejtorja e Doganave, Elisa Spiropali, e cila ka vlerësuar me këtë rast kontributin që ka dhënë Dhoma Amerikane e Tregtisë në zhvillimin e marrëdhënieve konstruktive mes administratës doganore dhe komunitetit të biznesit.

Dhoma Amerikane e Tregtisë e merr këtë certifikatë në përvjetorin e saj të 15-të, me një histori të gjatë në marrëdhëniet e punës me doganat dhe përpjekjeve për të krijuar një urë bashkëpunimi me institucionin e doganave. Një nga traditat më të spikatura në Dhomen Amerikane është takimi i përvitshëm me Drejtorinë e Doganave në çdo fillim viti, duke ndihmuar që biznesi dhe drejtuesi i doganave të jenë të paktën një herë në vit në të njëjtën tyezë, ku flitet konkretisht për problematikat e biznesit. Vitet e fundit kjo marrëdhënie është intensifikuar edhe më shumë, duke sjellë një kontribut cilësor në normalizimin e marrëdhënieve mes doganave dhe biznesit.

AmCham receives Certificate of Merit on International Customs Day

The American Chamber of Commerce in Albania has been honored with a Certificate of Merit by the World Customs Organization, awarded on International Customs Day.

The award was delivered by Customs Director General Elisa Spiropali, who expressed appreciation for the contribution the American Chamber of Commerce in Albania has had in the development of constructive relations between the customs administration and the business community.

AmCham was granted the certificate on the 15th

anniversary of its founding, and the chamber has a long history of working together with customs in an attempt to create cooperation between officials and businesses.

One of the chamber's best established traditions has been an annual meeting with the head of the customs administration at the start of every year, helping business and customs representatives meet and speak about specific issues of concern. In recent years, the relationship has intensified, bringing a quality contribution to the normalization of relations between customs and businesses.


Members of AmCham Albania

A & A Group • A & B Business Consulting • A Bi Esse • ABC Health Foundation • Abcom • ACG-Advanced Construction Group • ACI Engineering • Adamb • Adriatic Ventures - ADI • Ak-Invest • Aksioner International Securities Brokerage • Alba Skela Construction • Albanian - American Enterprise Fund • Albanian Center for Economic Research • Albanian Duty Free Distribution • Albanian International School • Albanian Mobile Communications S.A. -AMC • Albanian-American Development Foundation • AlbAtlas • AlbGarden • Aldkris • Alkan/Sh • Alpha Bank • Alufloor Construction Group • Alumil - Albania • Ambra Srl. • American Noble Coffee • American Training Center • Amined • ANDE-LM Agency • Anosis • Antea Cement • Antoneta Gjeçi • APIA Wealth Management Albania • Artinel • Auto Star Albania • Avanttive Consulting • AVON Cosmetics Albania • B & B Food Service • Bakery Adriatica • Balfin-Balkan Finance Investment Group • Bankers Petroleum Albania Ltd. • Bar-Gallery-Art Cubi • Bar-Restaurant "Shqiponja" • Bayer D.O.O. Tirana Representative Office • Bërdica • Bereqet • Beta • Bilanc • Bindi • Birra Korça • Boga & Associates • Bozgo • Bozo & Associates • British American Tobacco Albania • Brunes • Bukuria Shqiptare Beli • CCS • Century 21 Albania • Century 21 The Point • CMB Albania • Co Casa • Coca-Cola Bottling Shqiperia • Coffee Club Albania • Communication Progress • Dajti Construxion • Dajti Ekspres • DDB Albania • Deloitte Albania • Deutsche Lufthansa' Albania Branch • Devoll Hydropower • DHL International Albania Ltd. • Dimapak • Dinamo • DM Consulting Services Albania • Easy pay • Eco Mat • EGNATIA Group • EHW • Elledi • Embassy of the United States • Enrico-Marinelli • Enternal • Era 2000 • Erbiron • Ermira Lulaj • Ernst & Young Albania • Europetrol Durrës Albania • Everest IE • Express Albania • Farmatech • Fatjon Lami • Fatmir Kazazi • Fejzo • Financial Services Volunteer Corps • Financial Union Tirana - Western Union • First • Florifarma • Friends Distribucion • Fufarma • Fusha • Fushe Kruja Cement Factory • GAEA-Green Alternative Energy • GDQ Foundation • Gender Alliance Development Center • German Albanian Logistics Agency (GALA) • GlaxoSmithKline Export Ltd. • Golden Eagle - Rogner Hotel Europapark • Grant Thornton • GSA • Harry T. Fultz Foundation • Hewlett Packard IT BV Albania Branch • Hoffmann - La Roche • Hotel Vila Alba • ICTS Albania • IDRA • Ilia Kabuci • InfoSoft Systems • Instituti Jeta e Re • Intech + • International Commercial Bank • Intersig Vienna Insurance Group • Intesa Sanpaolo Bank of Albania • Iris • Jordil • JT Internacional Tirana • Junior Achievement of Albania • Jupiter Computer Systems Ltd. • K.T & Associates • Kalo & Associates • Kantina e Pijeve Gj.K. Skënderbeu • Kastrati • KDF • KESH • Kika • Konsort • Korsel • KPMG Albania • Laura Pustina • Lincoln Centers of Albania • Llambi Karbunara • Loloçi & Associates • Marketing & Distribution, Albania • Marlotex • McCANN Tirana • Melgushi • Mermer Balliu • Messer Albagaz • Microsoft Albania • Miell - Tirana • Mifol Inerte • MRDC • Muça • National Chamber of Private Judicial Execution • NCH Advisors Inc. • Net-SFS • Nisatel • NOA • Optima Legal & Financial • P.V.N. Colosseo • Pelinku Jeans • Philip Morris Albania • PolitOn Centre • Porsche Albania • Prespa 2000 • PricewaterhouseCoopers Audit • Printec Albania • Cyprus) Limited • Procredit Bank • Professional & Business Women Association • Rametal • Real Estate "INF 93" • Regional Development Agency, Korça • Rejsi Farma • Relikaj Ltd. • Renova • S & T Albania • Salltik • SHAFP Sigal Life Uniqa Group Austria • Sheraton Tirana Hotel • SIGAL Uniqa Group Austria • Sigma InterAlbanian Vienna Insurance Group • Small Business Association, Korça • Sokol Arishta • Starnet • Stefani & Co • Studio Mallkuçi & Sadushaj • Taçi Oil International • Tafaj "Z" • Tashko Pustina - Attorneys • TCN • Tea Construction & Petrol • Teknoxgroup Albania • Tendence 3A • Tetra Tech ARD • Teuta Durrës • Tirana Bank • Tirana Business Park • Tirana International Airport • Tirana Leasing • Tirex Exploration • Tobacco Holdings Group • Tona Co • Tonucci & Partners Albania • Transatlantic Albania Ltd • Trema Engineering 2 • TriMed • Turgut Ozal • TUV Austria Albania • Ulysses Enterprises • United Bank of Albania • United Transport-UPS • University of New York Tirana • Valu Add Management Services • Vasil Shandro • Veneto Banka • Vodafone Albania • Andela (Woodrow Wilson School) • World Vision Albania • Zaka & Kosta Attorneys at Law • Zhan 92 • ZICO



ENGINEERING

for a better living



Rr. Murat Toptani Nr.25
fusha_shpk@yahoo.com ; info@fusha.al
www.fusha.al